

## **RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR**

### ***Mbi Auditimin ligjor te detyrueshem te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga „Partia Bashkimi Per te Drejtat e Njeriut“***

#### **Komisionit Qendror te Zgjedhjeve, Tirane**

##### ***Te nderuar zoterinj,***

Ne zbatim te Ligjit Nr. 10.019 dt 29/12/2008 „Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise“ dhe Udhezimit te KQZ –se Nr 8 dt 25/03/2009 „Per miratimin e kriterëve dhe procedurave per perzgjedhjen dhe emerimin e eksperteve kontabel te licencuar, per auditimin e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga subjektet zgjedhore per fushaten zgjedhore“ me vendimin Nr. 605 dt. 14/09/2009 „Per shpalljen e rezultatit te shortit, per emertimin e eksperteve kontabel te licencuar te cilet do te kryejne auditimin e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga subjektet zgjedhore per fushaten zgjedhore“ jam emeruar per auditimin e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara, per fushaten zgjedhore te Partise Bashkimi per te Drejtat e Njeriut.

Me shkresen Nr. 4110 dt. 16/09/2009 jam njoftuar per rezultatin e shortit te dates 14/09/2009 dhe me shkresen 4115/1 dt 17/09/2009 kam lidhur kontraten e sherbimit me Komisionin Qendror te Zgjedhjeve Tirane.

Bazuar ne objektin e kontrates, kerkohet te kryhet auditimi ligjor i detyrueshem ne fondet e perfituara dhe shpenzuara nga Partia Bashkimi per te Drejtat e Njeriut per fushaten zgjedhore ne perputhje me ligjin Nr. 10.019 dt 29/12/2008 „Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise“, ligjin Nr 10.091 dt 05/03/2009 „Per auditimin ligjor, organizimin e Profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe Kontabilistit te Miratuar“ dhe Ligjit Nr.9.228 dt 29/04/2004 „Per kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare“ si dhe akteve nenligjore te nxjerra ne baze dhe per zbatimin e tyre.

Nga ana ime sipas kontrates se mesiperme u hartua plani i punes per auditimin e fondeve te cilen e kam dorezuar prane KQZ-se sipas shkreses 4281 dt 12/10/2009.

#### **I. Te dhena per Partine Bashkimi per te Drejtat e Njeriut.**

Partia Bashkimi per te Drejtat e Njeriut (**PBDNJ**), e krijuar me vendim Nr. 6/1 date 24/02/1992 te Ministrise se Drejtesise sipas ligjit 7502 dt 25/07/1991 “Per Partite Politike” eshte nje organizate politike e pavarur krijuar ne konformitet te plote me Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe legjislacionin ne fuqi. Partia Bashkimi per te Drejtat e Njeriut si qellim te saj ka mbrojtjen e te drejtave te minoriteteve, i cili eshte percaktuar ne akt themelimi dhe statut.

Selia e saj eshte Rruga Bulevardi “Bajram Curri” Nr. 32 prane Ministrise se Shendetesise Tirane.

Kryetari i saj eshte z. Vangjel Dule dhe financier eshte z. Thanas Poci.

## **II. Rregullat e Vleresimit**

### **Menyra e pregatitjes se Pasqyrave Finaciare**

Kontabiliteti eshte i ndertuar mbi bazen e parimeve te drejtave te konstatuara. Sipas kesaj menyre fondet e perfituara ne te holla jane regjistruar ne momentin e arketimit te tyre dhe fondet e perfituara ne forme materiale dhe sherbimi ne mometin e kryerjes duke i konvertuar ne vlere leku dhe shpenzimet jane pasqyruar ne momentin e konstatimit te tyre kur jane kryer.

### **Monedha Raportuese**

Partia ka perdorur ALL si monedha e baze e raportimit.  
Fondet e pefituara jane mare ne leke.  
Shpenzimet jane kryer ne ALL.

### **Taksat dhe Kontributet**

Partia eshte e perjashtuar nga taksat mbi fitimin.

## **1. KONTROLLI I REGJISTRIT TE POSACEM DHE DEKLARATAVE TE DHURUESVE FONDE JOPUBLIKE**

U kontrollua prane Subjektit Politik, Vendimi i Komisionit Qendror te Zgjedhjeve nr. 266 dt 01/06/2009 „Per miratimin e modelit te regjistrit te posacem qe duhet te perdorin Subjektet Politike per regjistrimin e fondeve te perfituara, per fushaten zgjedhore, si dhe modelin e deklarates qe duhet te nenshkruajne dhuruesit ne castin e dhurimit dhe rezultoi se:

Tabela e fondeve te perfituara, nga Partia Bashkimi per te Drejtat e Njeriut, ndaj personave fizike ose juridike, vendas per zgjedhjet ne Kuvendin e vitit 2009, eshte zero (0). Per kete shiko tabelen bashkangjitur raportit te plotesuar e nenshkuar nga Kryetari i Partise Bashkimi per te Drejtat e Njeriut z.Vangjel Dule.

Nuk ka asnje rast te plotesimit te deklarates „Mbi konfliktin e interesave per financimin e subjekteve zgjedhore“ pasi nuk ka perfituar asnje kandidat. (Shiko deklaraten bashkengjitur)

### **Mbi gjendjen e llogarise bankare**

U kontrollua nr i llogarise bankare me Nr. 020465011003173 me adrese Alpha Bank per periudhen nga 06/05/2009 deri 18/08/2009, nxjerrje llogarie bashkangjitur. Kjo Parti operon vetem ne kete banke. Gjendja ne fillim te 06/05/2009 eshte 7.374.616,99 leke dhe ne fund te periudhes, pra 18/08/2009 eshte 2.259.666,78 leke.

## **2. KONTROLLI I FONDEVE PUBLIKE PER SUBJEKTET ZGJEDHORE**

### **FONDET PUBLIKE**

Partia Bashkimi per te Drejtat e Njeriut ka perfituar fonde publike per fushaten zgjedhore te 28 Qershorit 2009 ne vleren 2.145.573 leke bazuar ne te drejten e saj si Parti Parlamentare, kjo e percaktuar dhe ne shkresen nr.6883 te Ministrise se Financave. Keto fonde jane arketuar duke kaluar ne llogarine bankare me date 30/06/2009 ne vleren 3.330.573 lekeku perfshihet vlera e mesiperme dhe financimet e marra per muajt Maj-Qershor 2009, financime qe kjo parti i merr cdo muaj nga Buxheti i Shtetit.

### **3. SHPENZIMET E KRYERA GJATE FUSHATES ZGJEDHORE 2009**

**Marrje salle me Qera.** Partia Bashkimi per te Drejtat e Njeriut per ushtrimin e aktivitetit te saj politik ka organizuar Konveten e Partise per celjen e fushates ku ka harxhuar fonde ne vleren 1.107.131 leke.

#### **REKLAMA TELEVIZIVE DHE TRANSMETIME SPOTESH**

Partia Bashkimi per te Drejtat e Njeriut ka harxhuar nga reklamat dhe spotet televizive per fushaten zgjedhore te 28 Qershorit 2009 si me poshte:

- |                              |  |
|------------------------------|--|
| 1. Per subjektin Top Channel | 3.446.163 leke sipas fatures 691 dt 24/06/2009 |
| 2. Per subjektin Vizion      | 1.253.900 leke sipas fatures 269 dt 19/06/2009 |
| 3. Per subjektin Al Sat      | 126.927 leke sipas fatures 73 dt 09/07/2009    |

Pra vlera totale per spote televizive eshte **4.826.990 leke**. Ne verifikimin e harxhimit te ketyre fondeve u pane librat e kontabilitetit ku ka rezultuar se ato jane te regjistruara sipas mandateve perkatese. Bashkangjitur jane faturat e likujduara nga kjo Parti.

#### **SHPENZIME PER FLETEVOLANTE, FLETEPALOSJE, REKLAMA, BANDEROLA E PRINTIME TE NDRYSHME**

Sipas faturave tatimore te shitjeve jane faturuar:

- |  |              |
|--|--------------|
| 1. Sherbime printime te ndryshme ne vleren | 75.000 leke  |
| 2. Flamure dhe bluza                       | 998.600 leke |
| 3. Printime banerash                       | 126.200 leke |
| 4. Filmime dhe fotografime                 | 120.000 leke |

---

**Vlera totale eshte 1.319.800 leke.**

#### **SHPENZIME TE TJERA**

- |   |               |
|---|---------------|
| 1. Organizim aktivitetesh per prezantim | 105.000 leke  |
| 2. Financim kandidate per deputete      | 350.000 leke. |

---

**Vlera totale eshte 455.000 leke.**

**Pra, Partia Bashkimi per te Drejtat e Njeriut ka shpenzuar per fushate elektorale te 28 Qershorit 2009 gjithsej vleren prej 7.708.921 leke** ku perballimi e ketyre shpenzimeve e ka bere nga fondi i dhene per fushaten elektorale ne vleren **2.145.573 leke** dhe **5.563.348 leke** perballuar nga fondet qe merr kjo parti nga financimet vjetore nga buxheti i shtetit.

Ne verifikim e shpenzimeve te mesiperme shoqeria mban drejt ne librat e kontabilitetit me mandatet perkatese dhe dokumenta justifikuese.

Ne e kryem auditimin ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit (SNA Nr 800). Keto standarte kerkojne, qe ne te planifikojme dhe te kryejme auditim per te zoteruar siguri te arsyeshme, se kjo pasqyre nuk permban anomali materiale. Auditimi perfshin shqyrtimin, mbi bazen e testeve, te fakteve qe mbeshtesin shumat dhe deklarimet ne pasqyren financiare. Auditimi perfshin gjithashtu, vleresimin e parimeve te kontabilitetit te ndjekura dhe vleresimet e rendesishme te bera nga Drejtimi, si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyres.

**Korce, me 31/10/2009**

**Eksperti Kontabel i Regjistruar**

**Dhimitraq PANO**

**Adresa : Rruga 1 Maji Pallati 17/8  
Lagja 9, Korce  
Cel : 0682420900  
Kodi Fiskal K33931045Q**